



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 335/5 Prot.

Tiranë, më 28.07. 2015

V E N D I M

Nr. 74, datë 28/07/2015

**Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e
Këshillit të Qarkut Elbasan**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nenet 14, germa "b", 32 dhe 33, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", të miratuar me Vendimin nr. 17, dt.11.03.2015 (më poshtë "Rregullores"), si dhe neneve 80-104, të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pas shqyrtimit të materialit, observacioneve dhe mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procesin e inspektimit të përgjithshëm, zhvilluar në institucionin e Këshillit të Qarkut Elbasan,

VËREJ SE:

Në zbatim të Vendimit nr. 24, datë 12.03.2015, "Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Elbasan", filloi inspektimi i përgjithshëm në subjektin, Këshilli i Qarkut Elbasan.

Objekti i inspektimit ishte i përgjithshëm dhe përfshinte të gjitha institutet e ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe mënyrën e administrimit të shërbimit civil në të gjitha aspektet, si: mënyrën e pranimi në shërbimin civil, lëvizjen paralele, ngritjen/uljen në detyrë, transferimin apo lirimin nga shërbimi civil të punonjësve në kushtet e ristrukturimit, përshtatshmërinë e përshkrimeve të pozicioneve të punës dhe të kërkesave të përgjithshme e të posaçme të tyre me cilësitë individuale të punonjësve të mbajtur në punë pas ristrukturimit, vlerësimet e punës, si dhe nëse ishin mbajtur parasysh dhe respektuar kërkesat e neneve 50 dhe 67, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", si dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave, Kreu III, "Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit".

Në përfundim të procesit të inspektimit, grupi i inspektimit ka hartuar projektraportin dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 335/3, datë 03.07.2015, *"Dërgohet projektraporti i inspektimit"*, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet në lidhje me materialin. Pas kësaj, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore në institucion, me shkresën nr.768/2 prot., datë 13.07.2015, *"Mbi dërgimin e projektraportit në lidhje me inspektimin në Këshillin e Qarkut Elbasan"*.

Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse, rezulton se subjekti i inspektuar është shprehur dakort me konkluzionet e arritura nga grupi i punës dhe nuk ka bërë asnjë vërejtje në lidhje me materialin.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pas shqyrtimit të përmbajtjes së raportit përfundimtar të inspektimit, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, të ndryshuar, si dhe nenet 32, 33, të Rregullores *"Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit"*, miratuar me vendimin nr. 17 dt.11.03.2015,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Këshilli i Qarkut Elbasan, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse të marrë vendimin përfundimtar të emërimit, në mënyrë nominale, për secilin nëpunës të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, sipas parashikimeve të nenit 50, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, *"Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil"*, të Këshillit të Ministrave (të dalë akti individual i riemërimit të çdo nëpunësi të DAMT-së dhe ky të administrohet dhe të jetë pjesë e dosjes së personelit).
3. Njësia përgjegjëse të marrë mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III, *"Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit"*, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *"Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil"* dhe ta administrojë atë në dosjen e personelit (dosjen individuale).

4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
5. Me kalimin e këtij afati, subjekti i inspektuar, Këshilli i Qarkut Elbasan, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Për këtë vendim të njoftohet Këshilli i Qarkut Elbasan dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit të Shqipërisë, duke u dërguar nga një kopje të raportit përfundimtar të inspektimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA